



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për :	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Burim Gërguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë	
Përmes:		
Nga:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	Datë: 25/09/2019
Zyrtarët përgjegjës:	Besim Myrtezani, U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Zbatim të Legjislacionit	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Obiliqit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar, **Vendimin Nr.150, për aprovimin e Planit Strategjik Parësor Shëndetësor për Komunën e Obiliqit 2020-2024**, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Obiliqit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë, si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkëngjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

QEVERIA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E SHENDETESISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org. 2.2
 Org. Jedinica
 Org. Unit

Nr. Prot. 25-5099
 Broj Prot.
 Prot. No.

Data: 25/09/2019
 Datum:
 Date:

No. pages 67-
 Prishtinë / a



HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
 REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVES VLADAKOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Data: 25-09-2019
 Datum:
 Date:

Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vite
-VI-	000-948/19		

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Departamenti Ligjor/Pravni Departament/Legal Department

Për:	Z.Adrijana Hodžić, Ministre e MAPL-së Z.Rozafa Ukimeraj, Sekretar i Përgjithshëm MAPL	
Kopje:	Z.Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Z.Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë Dr.Naim Bardiqi, Sekretar i Përhershëm në MSH	
Nga:	Z.Aferdita Hoxha, U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor	
Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Z.Kadrije Sherifi, udhëheqëse e Divizionit për hartim dhe harmonizim të legjisllacionit	Data:18/09/2019
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Obiliqit	
Lloji i Aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuari Ministër,
 E nderuara Sekertare,

Në pajtim me Rregulloren Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministries të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin nr.150 për aprovimin e Planit Strategjik Parësor Shëndetësor për Komunën e Obiliqit 2020-2024

I miratuar me 30/08/2019.

I dërguar për shqyrtim në MSh, me datë: 13/09/2019

Ministria e Shëndetësisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi me Ligjin për Shëndetësi nr. 04/L 125, Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2017 – 2021, Udhëzimin Administrativ 07-2018- Për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit.**

Mos pajtueshmëri të aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimi nr.150 për aprovimin e Planit Strategjik Parësor Shëndetësor për Komunën e Obiliqit 2020-2024.	<p>Ligji për Shëndetësi nr. 04/L 125, neni 8 dhe 18 përcakton se politikat shëndetësore hartohen nga Ministria e Shëndetësisë përfshirë edhe kujdesin parësor shëndetësor.</p> <p>Po ashtu, Ministria e Shëndetësisë ka hartuar Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2017 – 2021. Në kuadër të Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë 2017 – 2021, Ministria e Shëndetësisë ka themeluar grupin punues për hartimin e Planit Strategjik për Kujdes Parësor Shëndetësor. Pjesë e grupit punues është Kryesuesja e Kolegjumit për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Rrjedhimisht të gjitha Planet operative të Komunave në fushën e shëndetësisë duhet të jenë në përputhje me politikat nacionale për KPSH.</p> <p>Marrë parasysh këtë në pajtim me Strategjinë sektoriale të shëndetësisë 2017 – 2021, pas miratimit të Planit Strategjik të KPSH nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe Udhëzimit Administrativ 07-2018- Për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit, Komunat mund të nxjerrin dokumentet strategjike për zhvillim institucional .</p>

Ministria e Shëndetësisë, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,